



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 36/25 - 11/D  
Nr. i Fq./Br. St./No. Pg. 1/3  
Data/Idjumi/Date: 20.01.2025  
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Vendimi Nr. K-01/25  
Datë: 20.01.2025

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe nenin 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkatës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas Shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit në mbledhjen e datës, 20.01.2025, mori këtë:

#### V E N D I M

- I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi TMC Nordic A/S, nga Gebr. Heinemann SE & Co. KG, përmes Nobilis Holding GmbH dhe The Sidewalk Run ApS;
- II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

#### Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 05.12.2024, me Nr. Prot. 776/24-01/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, përmes znj. Blerina Ramaj - Përfaqësuese Ligjore, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi TMC Nordic A/S, nga Gebr. Heinemann SE & Co. KG, përmes Nobilis Holding GmbH dhe The Sidewalk Run ApS.

#### Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë: 20.12.2024;
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë: 20.12.2024.

#### Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro;
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro;

### 3. Marrëveshja për Blerjen e Aksioneve.

**Gebr. Heinemann SE&Co. KG**, e regjistruar sipas ligjeve të Gjermanisë, me numër regjistrimi: HRA 15017, me adresë të biznesit në Koreastr. 3, 20457 Hamburg, Gjermani. GH Group është një biznes familjar, me bazë në Hamburg, që operon dhe furnizon dyqane pa taksa. Aktivitetet e saj përfshijnë, shitjen e produkteve të udhëtimit me pakicë për operatorët e aeroporteve, linjave ajrore, operatorët e anijeve turistike dhe trageteve, dyqanet kufitare dhe shitjen me pakicë në zonat e tregtisë së lirë. E njëjta operon me 350 pika shitjeje me pakicë, të udhëtimeve, në 73 aeroporte ndërkombëtare, në bazë të marrëveshjeve të koncesionit ose qirasë me operatorët e aeroportit.

**Nobilis Holding GmbH**, ndërmarrje e regjistruar sipas ligjeve të Gjermanisë, me adresë të regjistruar në Rheingaustraße 32, 65201 Wiesbaden, Gjermani, e regjistruar në Gjykatën e Qarkut të Wiesbaden me numër regjistrimi HRB 31343. E njëjta vepron si partner shpërndarjeje dhe shërbimi për markat e parfumeve dhe kozmetikës në rajonin DACH. Klientët e Nobilis janë parfumeritë, dyqanet e mëdha, farmacitë dhe kanali i tregtisë elektronike. Nobilis merret shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve të ngjashme, që janë gati për dërgim tek partnerët e saj të shitjes me pakicë, respektivisht fokusi i saj është në shitjet me pakicë. Aksionar në Nobilis është z. Heuser, përmes Fux4future.

**The Sidewalk Run ApS**, ndërmarrje e regjistruar sipas ligjeve të Danimarkës, me numrin e regjistrimit CVR 32771335, me adresë të regjistruar të biznesit: Transformervej 8, 2860 Søborg, Danimarkë. E njëjta, e ka fokusin në njësi prodhimi. Kjo vepron si ndërmarrje holding, e cila është në pronësi të Heidi Behrens, Fiona Bahrens dhe Frederik Bahrens (ku secili ka nga 33.3% të aksioneve).

**TMC Nordic A/S**, ndërmarrje e regjistruar në, Transformervej 8, 2860 Søborg, Danimarkë, me numër të regjistrimit CVR 32466168. E njëjta vepron si një partner shpërndarjeje, për markat e bukuri në vendet Nordike. Ajo ofron mbështetje për partnerët e saj me një gamë shërbimesh, që përfshijnë menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, marketingun, shitjet dhe raportimin. E njëjta operon me 63 punonjës nga selia e saj në Kopenhagë, Danimarkë, si dhe nga degët lokale të shitjeve në Suedi dhe Norvegji, të cilat drejtohen nga filialet e saj:

TMC Nordic AB, Hammarbybacken 27, 120 30 Stockholm, Suedi dhe  
TMC Nordic AS, Droning Eufemias gate 16, 0191 Oslo, Norvegji.

#### **Tregu përkatës:**

**Tregu i produktit:** Tregu i produkteve për shitje (përfshirë shitjen me shumicë), të parfumeve dhe kozmetikës, në sektorin e shitjes me pakicë (të rregullt).

**Tregu gjeografik:** Tregu përkatës gjeografik, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.01/2023, tregu gjeografik do të jetë tregu që përfshinë zonën, në të cilën ndërmarrjet përkatëse përfshihen në furnizimin dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene dhe mund të dallohen nga kushtet në zonat fqinjë. Në këtë rast, tregu gjeografik mund të lihet i hapur.

**Analiza e konkurrencës:** Palët e përfshira në këtë transaksion nuk operojnë në të njëjtin treg produktesh, nuk kanë filiale të përbashkëta dhe as nuk kanë synime për të zgjeruar aktivitetet e tyre ekonomike në Kosovë. Kjo do të thotë se, ky përqendrim nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun e Kosovës, pasi ky transaksion nuk rezulton në mbivendosje horizontale apo marrëdhënie vertikale (në zinxhirin e furnizimit) mes aktiviteteve të palëve të përfshira. Blerja e aksioneve dhe marrja e kontrollit të kompanisë së synuar është një investim strategjik i Nobilis, duke i mundësuar asaj të hyjë në një treg të ri dhe në një zonë të ndryshme gjeografike. Ky veprim është pjesë e një strategjie më të gjerë për diversifikimin dhe zgjerimin

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1  
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)

e operacioneve në rajone të reja. Partneriteti me shitësin aktual është i rëndësishëm për suksesin e ardhshëm të kompanisë së synuar, sidomos në përmirësimin e performancës në sektorin e shitjeve të parfumeve dhe kozmetikës. Përmes këtij partneriteti, NOBILIS do të ketë mundësinë të shfrytëzojë potencialet e tregut të shitjeve me pakicë në vendet nordike, duke forcuar pozitat e tij në këtë rajon dhe duke kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e kompanisë së synuar.

**Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar:** Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për shkak se njëra palë në transaksion, gjeneron të ardhura në Kosovë përmes ndërmarrjeve të treta. Struktura e tregut të ndërmarrjes blerëse, në tregun e Republikës së Kosovës nuk do të ndryshojë. Transaksioni i propozuar nuk pritet të ndikojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese, për më tepër, objekti i kontratës, nuk është i lidhur drejtpërdrejt me tregun përkatës të Republikës së Kosovës, duke e bërë të pamundur që ky transaksion të ndihmojë në krijimin e ndonjë disavantazhi konkurrues në këtë treg. Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencën, respektivisht ky transaksion/blerja, nuk do të ndikojë në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon, me tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

#### Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

### AUTORITETI I KONKURENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare

Kaltrina Sela  
Nënkryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi-Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva